VENDIM
Nr. 683, datë 15.10.2014

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË AKSIONARE, NDËRMJET FEDERATËS SHQIPTARE TË RAFTING DHE MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 213, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe të ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e pëlqimit për krijimin e një shoqërie aksionare, ndërmjet Federatës Shqiptare të Rafting dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me qëllim ndërtimin dhe administrimin e një qendre sportive për sportin e "Rafting", e cila do të funksionojë në pronën me nr. 1051, me emërtim "Reparti ushtarak nr. 5013, nënrepart", me vendndodhje në Bigaz, Skrapar.

2. Raporti i aksioneve në krijimin e shoqërisë aksionare të jetë:

- 26% shteti, i përfaqësuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- 74% Federata Shqiptare e Rafting.

3. Krijimi i shoqërisë aksionare të jetë pa afat.

4. Kontributi i shtetit, përfaqësuar nga ministria përgjegjëse për sportin, të jetë vlera e pronës nr. 1051, me emërtim "Reparti ushtarak nr. 5013, nënrepart", me vendndodhje në Bigaz, Skrapar, sipas rivlerësimit që do t'i bëhet kësaj prone para regjistrimit të shoqërisë pranë QKR-së.

5. Emërtimi i shoqërisë të vendoset në aktin e themelimit me marrëveshje ndërmjet aksionarëve.

6. Autorizohet Ministria e Arsimit dhe Sportit, në zbatim të këtij vendimi, për themelimin dhe krijimin e shoqërisë aksionare, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

7. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave të kryejnë procedurat për kalimin e pronës nr. 1051, me emërtim "Reparti ushtarak nr. 5013, nënrepart", me vendndodhje në Bigaz, Skrapar, në kapitalin e shoqërisë aksionare, që do të krijohet sipas këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama